



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

KA 32

K. Ankimore 32

Data 19.10.2023
Nr. Prot 9240

KËRKUES: KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

OBJEKTI: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

DREJTUAR: KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncimin me nr. 413 ID nga Qendra "Qëndresa Qytetare" për shkelje administrative nga ana e kryetarit dhe kandidatit për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe si dhe nga ana e drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroshan, Malësi e Madhe, për të cilin pretendohet se ka patur shkelje administrative të parashikimeve ligjore.

Denoncimi është administruar në formë shkresore, nëpërmjet provave link dhe provave fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, nenet 91, 92, 717 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucioni publik nëpërmjet adresës së postës elektronike, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- Denoncimi nr. 413 ID, " Më datë 3 Maj 2023, në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroshan, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Malësisë së Madhe, njëherazi dhe kryetar i kësaj bashkie, z. Tonin Marinaj dhe banorëve të fshatit. Siç rezulton edhe nga pamjet filmike, z. Marinaj e ka zhvilluar këtë aktivitet në ambientet e shkollës."

Më datë 11.5.2023, nëpërmjet adresës së postës elektronike, palëve ne proces, i është kërkuar informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Më datë 15.5.2023, Zyra Vendore Arsimore Malësi e Madhe, bën me dije se "Zyra Vendore Arsimore Malësi e Madhe, nuk ka dijeni në lidhje me takimin e zhvilluar me datë 3.5.2023 dhe gjatë gjithë kësaj periudhe ka qënë e angazhuar në zbatimin me përpikmëri dhe përgjegjësi të plotë të akteve ligjore në përgjithësi dhe të Kodit Zgjedhor në veçanti, me qëllim zbatimin dhe respektimin e dispozitave ligjore, si dhe mbarëvajtjen dhe moscënimin në asnjë moment të procesit mësimor, që është edhe qëllimi kryesor i këtij institucioni."

Menjëherë, pasi jemi njoftuar nga ana juaj në lidhje me këtë rast, i është kërkuar informacion drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi" Pjetroshan, i cili ka informuar se:

"Me datë 3 Maj 2023 stafi pedagogjik i shkollës ka qëndruar në punë si zakonisht deri në ora 14:00. Me përfundimin e procesit mësimor kemi mbyllur derën e shkollës dhe kemi ikur në shtëpi. Nuk kemi patur dijeni dhe as kontakte me persona të ndryshëm për zhvillimin e një takimi elektorral nga kryetari i bashkisë dhe subjekti PS në oborrin e shkollës. Theksojmë se, shkolla nuk ka roje dhe asnjë nga pjesëtarët e stafit pedagogjik nuk është banor i fshatit Pjetroshan që të pengonte pjesëmarrësit të hynin në oborrin e shkollës. Sipas informacioneve që mora ditët më pas, ka patur një konflikt me pronarët e tokës ku do të zhvillohej takimi dhe nuk është lejuar, prandaj takimi është spostuar në oborrin e shkollës."

Pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27.07.2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përgjigje të kërkesës sonë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare ndër të tjera bën me dije se: "Më datë 3 Maj 2023, stafi pedagogjik i shkollës ka qëndruar në punë si zakonisht deri në orën 14:00. Me përfundimin e procesit mësimor kemi mbyllur derën e shkollës dhe kemi ikur në shtëpi. Nuk kemi patur dijeni dhe as kontakte me persona të ndryshëm për zhvillimin e një takimi elektorral nga kryetari i bashkisë dhe subjekti PS në oborrin

e shkollës. *Theksojmë se shkolla nuk ka roje dhe asnjë nga pjesëtarët e stafit pedagogjik nuk është banor i fshatit Pjetroschan*".

Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ, u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 06.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike nuk u paraqit asnjë prej palëve të njoftuara.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimin e regjistruar me nr. 413 ID rezultoi se:

Nga sa evidentohet nga deklarimi i mbajtur në postimin publik në faqen zyrtare në "facebook" të kandidatit z. Tonin Marinaj, vihet re se kemi të bëjmë me një takim me karakter elektoral ku evidentohen materialet zgjedhore, banera me logon dhe sloganet e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", të cilat gjithashtu përmbajnë edhe emrin e kandidatit në garën për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Qëllimi zgjedhor i këtij takimi provohet edhe nga qëndrimi i mbajtur nga kandidati i cili në postimin e tij shprehet se: *"Pjetroschani prej dekadash ka zgjedhur të ecë vetëm përpara pavarësisht rrethanave dhe sfidave. Ky qëndrim i tyre ka nxjerrë figura të rëndësishme dhe me kontribut të çmuar për Malësinë e Madhe, por dhe për Shqipërinë. I falenderoj nga zemra të gjithë banorët e Pjetroschanit që vazhdimisht më kanë mbështetur dhe ju premtoj se në fillimin e mandatit të ardhshëm do të kryhet investimi në rrugën e fshatit dhe rikonstrukcioni i shkollës 9-vjeçare. #VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa"*

Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në rastin e denoncimit nr. 413 ID, në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor, drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroschan, Malësi e Madhe, z. Kastriot Dragaj ka vënë në dispozicion të kandidatit për kryetar bashkie, ambientet e shkollës për qëllime zgjedhore.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- Z. Tonin Marinaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe, gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë;



- Z. Kastriot Dragaj, Drejtor i shkollës 9-vjeçare “Fran Murriz”, në Pjetroschan, Malësi e Madhe gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimin nr. 796, datë 6.10.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 413 ID, për shkelje administrative”;
- Denoncimi nr. 413 ID dhe materialet fotografike të aktivitetit;
- Komunikimi nëpërmjet postës elektronike me personat objekt hetimi;
- Shkresa administruar nga KQZ me nr. 6524 Prot., datë 2.8.2023, me lëndë “Dërgim relacioni për denoncimin me nr. 413.”, nga z. Tonin Marinaj

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 796

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT REGJISTRUAR ME NR. 413 ID, TË QENDRËS "QËNDRESA QYTETARE", NDAJ Z. TONIN MARINAJ KRYETAR DHE KANDIDAT PËR KRYETAR BASHKIE PËR BASHKINË MALËSI E MADHE SI DHE NDAJ Z. KASTRIOT DRAGAJ DREJTORI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE "FRAN MURRIZI", NË PJETROSHAN, MALËSI E MADHE PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 06 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Qendra "Qëndresa Qytetare"

SUBJEKT: Z. Tonin Marinaj, kryetar dhe kandidat për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe
Z. Kastriot Dragaj drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroschan, Malësi e Madhe

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92, 171 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 796

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 413 ID për shkelje administrative"

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë denoncime për shkelje administrative nga ana e kryetarit dhe kandidatit për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe si dhe nga ana e drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroshan, Malësi e Madhe, për të cilin pretendohet se ka patur shkelje administrative të parashikimeve ligjore.

Denoncimi është administruar në formë shkresore, nëpërmjet provave link dhe provave fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Denoncimi regjistruar me nr. 413 ID i ardhur shkresërisht i administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga ana jonë me nr. 4859 prot., datë 9.5.2023, ndaj Z. Tonin Marinaj, Kandidat dhe Kryetar i bashkisë Malësi e Madhe, si dhe z. Kastriot Dragaj, Drejtor i shkollës 9 vjeçare " Fran Murrizi", Malësi e Madhe, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilin pretendohet si vijon:

" Më datë 3 Maj 2023, në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroshan, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Malësisë së Madhe, njëherazi dhe kryetar i kësaj bashkie, z. Tonin Marinaj dhe banorëve të fshatit. Siç rezulton edhe nga pamjet filmike, z. Marinaj e ka zhvilluar këtë aktivitet në ambientet e shkollës."

Neni 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 796
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 413 ID për shkelje administrative"

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtarinë publike për të cilat nga pala denoncuese pretendohet se është kryer shkelje administrative.

Më datë 11.5.2023, nëpërmjet adresës së postës elektronike, palëve ne proces, i është kërkuar informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Më datë 15.5.2023, Zyra Vendore Arsimore Malësi e Madhe, bën me dije se *“Zyra Vendore Arsimore Malësi e Madhe, nuk ka dijeni në lidhje me takimin e zhvilluar me datë 3.5.2023 dhe gjatë gjithë kësaj periudhe ka qënë e angazhuar në zbatimin me përpikmëri dhe përgjegjësi të plotë të akteve ligjore në përgjithësi dhe të Kodit Zgjedhor në veçanti, me qëllim zbatimin dhe respektimin e dispozitave ligjore, si dhe mbarëvajtjen dhe mospërcënimin në asnjë moment të procesit mësimor, që është edhe qëllimi kryesor i këtij institucioni.*

Menjëherë, pasi jemi njoftuar nga ana juaj në lidhje me këtë rast, i është kërkuar informacion drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi” Pjetroschan, i cili ka informuar se:

“Me datë 3 Maj 2023 stafi pedagogjik i shkollës ka qëndruar në punë si zakonisht deri në ora 14:00. Me përfundimin e procesit mësimor kemi mbyllur derën e shkollës dhe kemi ikur në shtëpi. Nuk kemi patur dijeni dhe as kontakte me persona të ndryshëm për zhvillimin e një takimi elektorral nga kryetari i bashkisë dhe subjekti PS në oborrin e shkollës. Theksojmë se, shkolla nuk ka roje dhe asnjë nga pjesëtarët e stafit pedagogjik nuk është banor i fshatit Pjetroschan që të pengonte pjesëmarrësit të hynin në oborrin e shkollës. Sipas informacioneve që mora ditët më pas, ka patur një konflikt me pronarët e tokës ku do të zhvillohej takimi dhe nuk është lejuar, prandaj takimi është spostuar në oborrin e shkollës.”

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. 687, datë 09.07.2023 “Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 405 ID, 410 ID, 412 ID, 413 ID dhe 414 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, kam vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 413 ID.

Pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27.07.2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përgjigjë të kërkesës sonë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare ndër të tjera bën me dije se *“Më datë 3 Maj 2023, stafi pedagogjik i shkollës ka qëndruar në punë si zakonisht deri në orën 14:00. Me përfundimin e procesit mësimor kemi mbyllur derën e shkollës dhe kemi ikur në shtëpi. Nuk kemi patur dijeni dhe as kontakte me persona të ndryshëm për zhvillimin e një takimi elektorral nga kryetari i bashkisë dhe subjekti PS në oborrin e shkollës. Theksojmë se shkolla nuk ka roje dhe asnjë nga pjesëtarët e stafit pedagogjik nuk është banor i fshatit Pjetroschan”.*



Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ, u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 06.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike nuk u paraqit asnjë prej palëve të njoftuara.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimin e regjistruara me nr. **413 ID** rezultoi se:

Nga sa evidentohet nga deklarimi i mbajtur në posimin publik në faqen zyrtare në "facebook" të kandidatit z. Tonin Marinaj, vihet re se kemi të bëjmë me një takim me karakter elektoral ku evidentohen material zgjedhore, banera me logon dhe sloganet e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", të cilat gjithashtu përmbajnë edhe emrin e kandidatit në garën për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Qëllimi zgjedhor i këtij takimi provohet edhe nga qëndrimi i mbajtur nga kandidati i cili në postimin e tij shprehet se: *"Pjetroshani prej dekadash ka zgjedhur të ecë vetëm përpara pavarësisht rrethanave dhe sfidave. Ky qëndrim i tyre ka nxjerrë figura të rëndësishme dhe me kontribut të çmuar për Malësinë e Madhe, por dhe për Shqipërinë.*

I falenderoj nga zemra të gjithë banorët e Pjetroshanit që vazhdimisht më kanë mbështetur dhe ju premtoj se në fillimin e mandatit të ardhshëm do të kryhet investimi në rrugën e fshatit dhe rikonstrukcioni i shkollës 9-vjeçare.

#VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa"

Neni 91, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se *"Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia."* Komisioni Rregullator, në vendimin nr. 9 në nenin 3, pika 1.3/c, i Komisionit Rregullator, qartësisht ka përcaktuar se *"veprimtari të ndaluara", janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: "vënien në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit".*

Rezultoi e provuar gjithashtu se kryetari i bashkisë njëkohësisht dhe kandidat për kryetar të bashkinë Malësi e Madhe, me zhvillimin e këtij aktiviteti elektoral në ambientet e shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi" Pjetroshan, Malësi e Madhe, konstatohet se ka përdorur burime publike

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 796
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 413 ID për shkelje administrative"

në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore. Kryetari në detyrë i bashkisë nuk mund të përdor institucione publike në interes të fushatës elektorale dhe as në mbështetje të fushatës së tij. Përdorimi i këtyre aseteve nga ana e kryetarit përbën qartësisht veprimtari të ndaluar sipas vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në rastin e denoncimit nr. **413 ID**, në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor, drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroschan, Malësi e Madhe, z. Kastriot Dragaj **ka vënë në dispozicion** të kandidatit për kryetar bashkie, ambientet e shkollës për qëllime zgjedhore.

Për sa më sipër, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar ku parashikohet se "*shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë*", për pasojë, vlerësoj se z. Tonin Marinaj, në cilësinë e subjektit zgjedhor, kandidat për kryetar bashkie, në bashkinë Malësi e Madhe, gjendet në shkelje të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 2, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se, "*Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë.*", për pasojë pasi u vlerësua në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroschan, Malësi e Madhe, z. Kastriot Dragaj, është në shkelje të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92, 171 pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 796

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 413 ID për shkelje administrative"

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për:
 - a) Z. Tonin Marinaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe në vlerën në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë;
 - b) z. Kastriot Dragaj drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroshan, Malësi e Madhe, në vlerën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5

vjet

Punoi:

I.Horanliu


M.Koja

A. Lamçe

Y.Merkaj



Ilirjan CELIBASHI



Data: 06 Tetor 2023

Nr: 796

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 413 ID për shkelje administrative"

6

Re: Kërkesë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, Bashkia Malesi e Madhe dhe ZVA Malesi e Madhe (413)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Wed 10/4/2023 2:31 PM

To: arban gjoka <arban-gj@hotmail.com>; ZVA Malësi e Madhe <ZVAmalesimadhe@arsimi.gov.al>

Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Bcc: Ylli Merkaç <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Kojë <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përsëhendetje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi hetimin administrativ të nisur ndaj Institutit Tuaj.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegimet tuaja, ditën e premte, më datë 6 Tetor 2023, ora 12:00, në adresë Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Thursday, July 27, 2023 1:48 PM

To: arban gjoka <arban-gj@hotmail.com>; ZVA Malësi e Madhe <ZVAmalesimadhe@arsimi.gov.al>

Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Subject: Kërkesë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, Bashkia Malesi e Madhe dhe ZVA Malesi e Madhe (413)

Përsëhendetje,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar denoncimin e regjistruar me nr. **413 ID**, me objekt shpërdorimin e burimeve publike me vënie në dispozicion të subjektit zgjedhor të ambienteve të shkollës 9- vjeçare për qëllime zgjedhore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në kuadër të hetimit administrativ të plotë dhe të gjithanshëm ka administruar të gjitha provat dhe pretendimet tuaja në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Duke qënë se ndodhemi në fazën e përfundimit të hetimit administrativ kërkojmë nga ana juaj paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, me shkrim, lidhur me procesin administrativ, përpara se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të vijojë me vendimmarrje mbi këtë rast.

Përsa më sipër, afati për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare është brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e këtij njoftimi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime
Sent: Thursday, May 11, 2023 2:44 PM
To: arban gjoka <arban-gj@hotmail.com>; ZVA Malësi e Madhe <ZVAmalesiemaadhe@arsimi.gov.al>
Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>
Subject: Kerkese per informacion, Bashkia Malesi e Madhe dhe ZVA Malesi e Madhe (413)

Pershendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim, i administruar me nr. 4859 prot. datë 09.05.2023, nga Qendra "Qendresa Qytetare" nepermjet te cilit nder te tjera pretendohet si vijon:

1. *"Me date 3 maj 2023, ne ambientet e jashtme te shkolles 9-vjecare "Fran Murrizi", ne Pjetroshan, eshte zhvilluar nje takim mes kandidatit te Partise Socialiste per Bashkine e Malesise se Madhe, njeherazi dhe krytar i kesaj bashkie, z.Tonin Marinaj dhe banoreve te fshatit. Sic rezulton edhe nga pamjet filmike, z.Marinaj e ka zhviluar kete aktivitet ne ambientet e shkolles."*

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për sa pretendohet nga denoncuesi, brenda 2 (dy) ditëve.

Ju informojmë se, referuar nenit 169, të Kodit Zgjedhor "Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione që parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë"

Bashkelidhur me kete kerkese, po ju dergojme denoncimin te njehesuar me origjinalin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kerkese per informacion, Bashkia Malesi e Madhe dhe ZVA Malesi e Madhe (413)


denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Thu 5/11/2023 2:44 PM

To: arban gjoka <arban-gj@hotmail.com>; ZVA Malësi e Madhe <ZVAmalesiemadhe@arsimi.gov.al>

Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Bcc: Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

 1 attachments (986 KB)

Denoncimi 413ID.pdf

Pershendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim, i administruar me nr. 4859 prot. datë 09.05.2023, nga Qendra "Qendresa Qytetare" nepermjet te cillit nder te tjera pretendohet si vijon:


1. *"Me date 3 maj 2023, ne ambientet e jashtme te shkolles 9-vjecare "Fran Murrizi", ne Pjetroshan, eshte zhvilluar nje takim mes kandidatit te Partise Socialiste per Bashkine e Malesise se Madhe, njeherazi dhe krytar i kesaj bashkie, z.Tonin Marinaj dhe banoreve te fshatit. Sic rezulton edhe nga pamjet filmike, z.Marinaj e ka zhvilluar kete aktivitet ne ambientet e shkolles."*

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për sa pretendohet nga denoncuesi, brenda 2 (dy) ditëve.

Ju informojmë se, referuar nenit 169, të Kodit Zgjedhor "Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione që parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë"

*Bashkelidhur me kete kerkese, po ju dergojme denoncimin te njehesuar me origjinalin.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KRYETARI

Nr. 91/54 Prot.

Koplik, më: 31.05/2023

Lënda: Dërgim relacioni për denoncimin me nr 413.

KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE
Tiranë

Në përgjigje të emalit të dates 11.05.2023 ku keni kërkuar informacion mbi denoncimin e dërguar pranë KQZ nga Qendra "Qendresa Qytetare" për aktivitetin e zhvilluar ne ambientet e Shkolles 9-Vjeçare Fran Murrizi Pjetroschan, ju kemi paraqitur parashtimet tona.

Me datë 3 maj 2023, në ambientet e jashtme te shkolles 9-vjecare "Fran Murrizi", ne Pjetroschan, eshte zhvilluar nje takim mes kandidatit te Partise Socialiste per Bashkine e Malesise se Madhe, njeherazi dhe krytar i kesaj bashkie, z.Tonin Marinaj dhe banoreve te fshatit. Sic rezulton edhe nga pamjet filmike, z.Marinaj e ka zhviluar kete aktivitet ne anbientet e jashtme të shkolles 9-vjecare "Fran Murrizi", ne Pjetroschan.

Theksojme se Bashkia Malësi e Madhe dhe kryetari z.Tonin Marinaj njëherazi kandidat i Partise Socialiste për Bashkinë e Malesi Madhe gjatë gjithë kohes ka pasur angazhimin maksimal në zbatimin e Ligjit 10019, datë 28.12.2008 të "Kodit Zgjedhor" në RSH i ndryshuar dhe Vendimit Nr 9 të Komisionit Rregullator "Për Rregullat e Raportimit të Veprimtarive me karakter publik të çdo Institucioni Publik, e me kapital shtetëror, Agjencive, Enteve Shtetërore, kategoritë e veprimtarive të Ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Logjistike të Administratës Shtetërore para Zgjedhjeve.

Për shkak të një konflikti të lindur me disa banorë përreth shkolles që kanë pretendime pronësie per sheshin e fshatit që është jashte ambienete të shkolles dhe për të mos agravuar situaten pasi banoret ishin mbledhur perreth nisur nga keto rrethana jemi detyruar qe ta zhvillojme aktivitetin në një pjesë te oborrit të shkolles,por anejhere per te shkrelur dispozitat ligjore

Bashkia Malësi e Madhe, Kryetari z.Tonin Marinaj dhe çdo strukturë apo institucion varësie kanë qenë të predispozuar të zbatojnë rregullat dhe detyrimet që na ngarkon ligji gjatë gjithë fushates për zgjedhjet vendore të 14.05.2023.

Përsa më sipër i qëndrojmë pretendimeve tona dhe kërkojmë pushimin e proçedimit administativ për mosdeklarim aktivitetesh.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!





KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE
ADRESIMI I DOKUMENTACIONIT HYRËS NË KQZ

Drejtorise që i shkon dokumentacioni:

Kabineti

SP

SAB

DPAZ

DAZ

DLD

DVJ

DSZMFM

DPRRESHM

DL

DKK

DMB

DBNJSHM

Veprimet e rekomanduara

Përgjigje

Seancë publike

Ndjekje/ Raportim

Shqyrtim

Dijeni

Vlerësim

Rekomandime të tjera

Z. Hoxhallari

21-08-2023

[Signature]

Afati

ditë

KOMISIONERI
Ilirjan Celibashi

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KRYETARI

Nr. 91/52 Prot.

Koplik, më: 12/05/2023

Lënda: Dërgim informacioni për denoncimin me nr 413.

KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE
Tiranë

Në përgjigje të emalit të dates 11.05.2023 ku kërkoni informacion mbi denoncimin e dërguar pranë KQZ nga Qendra "Qendresa Qytetare" për aktivitetin e zhvilluar në ambientet e Shkolles 9-Vjecare Fran Murrizi Pjetrosan, ju informojmë se:

Me date 3 maj 2023, në ambientet e jashtme të shkolles 9-vjecare "Fran Murrizi", në Pjetrosan, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partise Socialiste për Bashkinë e Malesisë së Madhe, njëherazi dhe krytar i kësaj bashkie, z.Tonin Marinaj dhe banorëve të fshatit. Sic rezultoi edhe nga pamjet filmike, z.Marinaj e ka zhvilluar këte aktivitet në ambientet e jashtme të shkolles 9-vjecare "Fran Murrizi", në Pjetrosan.

Theksojmë se Bashkia Malësi e Madhe dhe kryetari z.Tonin Marinaj njëherazi kandidat i Partise Socialiste për Bashkinë e Malesisë së Madhe gjatë gjithë kohës ka pasur angazhimin maksimal në zbatimin e Ligjit 10019, datë 28.12.2008 të "Kodit Zgjedhor" në RSH i ndryshuar dhe Vendimit Nr 9 të Komisionit Rregullator "Për Rregullat e Raportimit të Veprimtarive me karakter publik të çdo Institucioni Publik, e me kapital shtetëror, Agjencive, Enteve Shtetërore, kategoritë e veprimtarive të Ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Logjistike të Administratës Shtetërore para Zgjedhjeve.

Për shkak të një konflikti të lindur me disa banorë përreth shkolles që kanë pretendime pronësie për sheshin e fshatit që është jashtë ambienteve të shkolles dhe për të mos agruar situatën pasi banorët ishin mbledhur përreth nisur nga këto rrethana jemi detyruar që ta zhvillojmë aktivitetin në një pjesë të oborrit të shkolles, por anjehere për të shkrelur dispozitat ligjore

Bashkia Malësi e Madhe, Kryetari z.Tonin Marinaj dhe çdo strukturë apo institucion varësie janë të predispozuar të zbatojnë rregullat dhe detyrimet që na ngarkon ligji.

Duke qenë në këto kushte kërkojmë mosfillimin e procedimit administrativ për mosdeklarim aktivitetesh.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!






Kthim përgjigje kërkesës për informacion

ZVA Malësi e Madhe <ZVAmaleciemadhe@arsimi.gov.al>

Fri 5/12/2023 12:19 PM

To:denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

 2 attachments (522 KB)

Shkresa mbi zbatimin e percaktimeve ligjore ne institucionet arsimore.pdf; Shkresa e Ministres së Arsimit dhe Sportit me nr. 730 1 prot , datë 10. 02. 2023.docx;

Përshëndetje,

Në përgjigje të e-mailit të datës 11.05.2023, në lidhje me denoncimin nr. 4859 prot. datë 09.05.2023, nga Qendra "Qendresa Qytetare", ju informojmë si më poshtë vijon:

Zyra Vendore Arsimore Malësi e Madhe, nuk ka dijeni në lidhje me takimin e zhvilluar me datë 03.05.2023 dhe gjatë gjithë kësaj periudhe ka qënë e angazhuar në zbatimin me përpikmëri dhe përgjegjësi të plotë të akteve ligjore në përgjithësi dhe të Kodit Zgjedhor në veçanti, me qëllim zbatimin dhe respektimin e dispozitave ligjore, si dhe mbarëvajtjen dhe mosçënimin në asnjë moment të procesit mësimor, që është është edhe qëllimi kryesor i këtij institucioni.

Menjëherë, pasi jemi njoftuar nga ana juaj në lidhje me këtë rast, i është kërkuar informacion drejtorit të shkollës 9 vjeçare "Fran Murrizi" Pjetroschan, i cili ka informuar se:

"Me datë 3 maj 2023 stafi pedagogjik i shkollës ka qëndruar në punë si zakonisht deri në ora 14.00. Me përfundimin e procesit mësimor kemi mbyllur derën e shkollës dhe kemi ikur në shtëpi. Nuk kemi patur dijeni dhe as kontakte me persona të ndryshëm për zhvillimin e një takimi elektorale nga kryetari i bashkisë dhe subjekti PS në oborrin e shkollës. Theksojmë se, shkolla nuk ka roje dhe asnjë nga pjesëtarët e stafit pedagogjik nuk është banor i fshatit Pjetroschan që të pengonte pjesëmarrësit të hynin në oborrin e shkollës. Sipas informacioneve që mora ditët më pas, ka patur një konflikt me pronaret e tokës ku do të zhvillohej takimi dhe nuk është lejuar, prandaj takimi është spostuar në oborrin e shkollës."

Bashkëlidhur ju dërgojmë njoftimin zyrtar të institucioneve arsimore parauniversitare të vartësisë lidhur me zbatimin e shkresës me nr. 730/1 prot , datë 10. 02. 2023 të Ministres së Arsimit dhe Sportit .

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

ZYRA VENDORE ARSIMORE MALËSI E MADHE

Adresa : Lagjja " Mehaj " Koplík , Malësi e Madhe , Shqipëri

E – mail : ZVAmaleciemadhe@arsimi.gov.al



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkakuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.


The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct

Dergim informacioni

arban gjoka <arban-gj@hotmail.com>

Fri 5/12/2023 10:55 AM

To:denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

 1 attachments (278 KB)

Relacion.pdf;

Bashkelidhur po iu dergojme informacionin e kerkuar!

Bashkia Malesi e Madhe

Arban Gjoka

Nep/Nderlidher me KQZ

Tiranë, më 09.05.2023

KALLËZIM

KALLËZUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga “Ali Pashë Gucia”, Pallati nr. 42 me adresë elektronike qendresaqytetare@gmail.com, me Drejtor Ekzekutiv **Z. Rigels Xhemollari**, përfaqësuar me autorizim nga Z. Dhimitër Zguro.

KUNDËR: **Z. Tonin Marinaj**, me detyrë Kryetar Bashkie dhe kandidat i Partisë Socialiste për Bashkinë Malësi e Madhe, me adresë: Koplík, Qëndër, Malësia e Madhe.
Dhe çdo personi tjetër, të pa identifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezultojnë se ka përgjegjësi administrative.

OBJEKTI:

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj Z. Tonin Marinaj dhe ndaj çdo personi tjetër përgjegjës.

DREJTUAR: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr. 4, Tiranë, përfaqësuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**.

BAZA LIGJORE: Nenet 91, pika 2, e nenit 171 dhe pika 1, e nenit 172, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”;
Neni 3, i Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

I nderuar Z. Komisioner,

Pasi jemi njohur me aktivitetin e mëposhtëm të organizuar nga, paraqesim para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, këtë kallëzim kundër Z. Tonin Marinaj dhe çdo personi tjetër, që gjatë hetimit administrativ do të rezultojnë se ka përgjegjësi, për arsyet si më poshtë vijon:

- Bosilje Malësi e Madhe
- ZVA





KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

ADRESIMI I DOKUMENTACIONIT HYRËS NË KQZ

Drejtorise që i shkon dokumentacioni:

Veprimet e rekomanduara

Kabineti

Përgjigje

SP

Seancë publike

SAB

Ndjekje/ Raportim

DPAZ

Shqyrtim

DAZ

Dijeni

DLD

Vlerësim

DVJ

Rekomandime të tjera

DSZMFM

Z. Hoxhamllari

DPRRESHM

DL

10-5-2023 Gulep

DKK

DMB

DBNJSHM

Afati

ditë

KOMISIONERI

Ilirjan Celibashi

Ilirjan Celibashi

I. RRETHANAT E CËSHTJES:

1. Më datë 3 maj 2023, në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”, në Pjetroshan, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Malësisë së Madhe, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, Z. Tonin Marinaj dhe banorëve të fshatit [Prova nr. 1 – Fotografi të shkollës 9-vjeçare dhe postimi i Z. Marinaj]. Siç rezulton nga pamjet filmike, Z. Marinaj e ka zhvilluar këtë aktivitet në ambientet e shkollës [Prova nr. 2 – Fotografi nga postimi i Z. Marinaj].¹

II. E DREJTA E APLIKUESHME:

2. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”:
- (i) **Neni 91 “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”** parashikon: *“1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.”*
 - (ii) **Neni 171 “Sanksionet administrative”** parashikon: *“1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve osenga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë. 2. Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë veprë penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë.”*
 - (iii) **Neni 172 “Sanksionet për subjektin zgjedhor për shkelje të ndalimeve të këtij ligji”** parashikon: *“1. Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë.”*
3. Vendimi i Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me

¹ Për më tepër shih:

<https://www.facebook.com/toni.malesia/posts/pfbid0oHXr1DwaBkVN3j2Bb79VVSJF2DXQU7fkvv252N24Z7rboDLBPqXd9fXYmMWukb9eI> ; <https://fb.watch/koWfEgK1eW/>



kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”:

- (i) **Neni 3 “Veprimtari të ndaluara”** parashikon: “1. Në zbatim të këtij vendimi: 1.3 “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësisve të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”.

III. ANALIZA LIGJORE:


A. Në lidhje me përdorimin e burimeve publike:

4. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të Kodit Zgjedhor me ato të vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator, që të ndodhemi përballë një shkeljeje administrative që lidhet me (keq)përdorimin e burimeve shtetërore, duhet që të plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative. Së pari, duhet që veprimtaria të jetë kryer nga një prej subjekteve të ngarkuar me detyrime nga ligji dhe aktet nënligjore. Së dyti, duhet që veprimtaria të përfshijë vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të Kodit Civil, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike. Dhe së treti, duhet që vënia në dispozicion e aseteve publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.

5. Përsa i takon kushtit të lidhur me subjektet, ligjvënësi në pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor bën një përcaktim të përgjithshëm duke sanksionuar se me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, burimet publike nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.

5.1 Në rastin konkret, Z. Tonin Marinaj është kandidat i Partisë Socialiste për kryetar në Bashkinë Malësia e Madhe dhe Partia Socialiste është një nga subjektet zgjedhore, të regjistruara në zgjedhjet e 14 majit 2023. Dhe për rrjedhojë, ky kusht i parë në lidhje me subjektin ndaj të cilit duhet të jenë vënë në mbështetje dhe prej të cilit janë përdorur burimet, plotësohet në rastin konkret.

6. Përsa i takon kushtit të dytë të lidhur me vënien në dispozicion të burimeve publike, duhet që burimet të jenë asete të luajtshme ose të paluajtshme në pronësi të organeve publike qendrore ose të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Në referim të nenit 142, të Kodit Civil, sende



të paluajtshme janë toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën, kurse të gjitha sendet e tjera, përfshirë dhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

6.1 Siç rezulton edhe nga rrethanat e çështjes, veprimtaria publike është zhvilluar në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”, në fshatin Pjetroschan, Njësia Administrative Kastriot. Përsa më sipër, në rastin konkret, provohet tërësisht përmbushja e këtij kushti të dytë.

7. Përsa i takon kushtit të tretë që lidhet me qëllimin e vënies në dispozicion të aseteve publike, referuar pikës 2, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, për efekt të ngarkimit me përgjegjësi administrative duhet që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore e publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.

8. Në rastin konkret, është e qartë që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore është bërë për qëllime zgjedhore. Kjo vërehet, së pari, nga vendosja e banderolave dhe materialeve të tjera propaganduese të Partisë Socialiste, duke përfshirë dhe thëniet dhe deklaratimet e tjera të përdorura në aktivitet.



IV. KONKLUZIONE:

9. Përsa më lart, mbështetur në nenin pikën 1 dhe 2, të nenit 91, në pikën 2, të nenit 171 dhe në pikën 1, të nenit 172, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë; pikën 1 dhe 2, të nenit 3të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9/2020, përfundimisht,

KËRKOJMË:


1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj Z. Tonin Marinaj dhe ndaj çdo personi tjetër përgjegjës.

Për “QËNDRESA QYTETARE”


Dhimitër ZGURO


Bashkëlidhur mund të gjeni:

- Prova nr. 1 – Fotografi të shkollës 9-vjeçare dhe postimi i Z. Marinaj;
- Prova nr. 2 – Fotografi nga postimi i Z. Marinaj.






Tonin Marinaj

May 3 at 3:08 PM

Pjetros hani prej dekadash ka zgjedhur të ecë vetëm përpara 🏃‍♂️ pavarësisht rrethanave dhe sfidave. Ky qëndrim i tyre ka nxjerrë figura të rëndësishme dhe me kontribut të çmuar për Malësinë e Madhe por dhe për Shqipërinë. I falenderoj nga zemra të gjithë bahorët e Pjetros hanit që vazhdimisht më kanë mbështetur dhe ju premtoj se në fillimin e mandatit të ardhshëm do të kryhet investimi në rrugën e ishantit dhe rikonstruktoni i shkollës 9-vjeçare.

#VetemPërpara
#KurMeMbrapa



+24









Bajza e Kastriotit

June 30, 2015 · 🌐

shkolla Pjetroshan

👍 18



Like



Comment



Share



Write a comment...





